

NDIHMONI FËMIJËT QË TË KENË SUKSES NË SHKOLLË

Ka shumë mënyra që ju si prind t'i ndihmoni fëmijës tuaj që të jetë i suksesshëm në shkollë. Më poshtë po japim disa ide për t'iu ndihmuar ju që të ndihmoni fëmijën tuaj në fushat e mëposhtme:

- **Detyrat e Shtëpisë:** Detyrat e shtëpisë jepen çdo mbrëmje. Zakonisht nxënësit kanë detyra gramatike ose matematike për të bërë. Fëmija juaj duhet t'i shkruajë detyrat e shtëpisë. Si prind, ju mund të kujdeseni që detyrat të bëhen pastër dhe plotësisht.
- **Shqiptimi:** Letrat me fotografi mund të ndihmojnë të mësuarit e shqiptimit të fjalëve. Ato mund të përdoren kështu: Fëmija shkruan nga njëra anë e letrës fjalën që do të shqiptohet. Nga ana tjetër, fëmija shkruan se çfarë nënkupton kjo fjalë. Fëmijët më të rritur, (nga klasa e dytë e sipër) mund të shkruajnë përkufizimin e fjalës. Fëmija pastaj shikon foton ose përkufizimin e fjalës dhe e shkruan vetë fjalën.
- **Shkrimi:** Nëse fëmija juaj është duke shkruajtur përgjigjet e pyetjeve pas leximit të tekstit ose librit ai duhet të përdorë një pjesë të pyetjeve në përgjigje. Për shembull - "Pse Xhoni i vodhi biskotat? Xhoni i vodhi biskotat sepse ishte i uritur." Kjo mënyrë do ta ndihmojë atë që të ndërtojë fjali të plota. Në përgjithësi, kur nxënësi duhet të shkruajë një tregim të shkurtër, ai duhet t'u përgjigjet këtyre pyetjeve: Cili është problemi që trajtohet në tregim? Si mund të zgjidhet problemi? Kur dhe ku ndodhin ngjarjet? Për kë bën fjalë tregimi? Mbani mend se gjatë shkrimit kanë shumë rëndësi pastërtia dhe shqiptimi prandaj është mirë që ta mbani fjalorin pranë.
- **Leximi:** Lexoni me zë bashkë me fëmijën çdo ditë. Mbani material të shumtë për lexim në shtëpi. Lexoni librin që po e lexon edhe fëmija juaj dhe bisedoni për të me fëmijën. Regjistroni librat në kasetë. Merreni fëmijën me vete në librari rregullisht. Ka shumë libra me ushtrime që mund t'i blini në dyqane prandaj bëni kujdes që të merrni librin që i përputhet nivelit të klasës së fëmijës.
- **Matematika:** Fëmija juaj duhet të praktikojë njohuritë themelore për mbledhjen dhe zbritjen ($4+5=9$, $9-5=4$) dhe nëse fëmija juaj është në klasën e tretë ose të katërt shumëzimin dhe pjesëtimin ($3\times 5=15$, $15\div 5=3$). Përgatit ose blej karta me shenja me problemin në njërën anë dhe përgjigjen në tjetrën. Mund të shpikni lojra ta bëni praktikën më zbavitëse.
- **Pjesëmarrja:** Vajtja në shkollë çdo ditë është e rëndësishme. Fëmija juaj duhet të flejë mirë natën, të hajë mëngjesin dhe të marrë me vete në shkollë pak ushqim ose drekën (ose të holla për të blerë drekën). Me vete fëmija duhet të marrë edhe detyrat e shtëpisë.

Për nxënësit që janë duke mësuar anglisht detyrat e leximit, shkrimit dhe shqiptimit mund të jenë më të vështira por praktika do t'i ndihmojë ata të përmirësohen. Gjetja e një shoku në lagje për të mësuar me të mundet gjithashtu të ndihmojë. Koha e lojës është kohë shumë e mirë për të mësuar gjuhën dhe për të përdorur disa nga aftësitë e mësuar në shkollë. Për më shumë informacion bisedoni me mësuesin e fëmijës tuaj, ai ose ajo mund t'iu japë materiale për të praktikuar në shtëpi. (Albanian 1 of 1)